

Skender ZHITIA

**BETEJA E LLAPASHTICËS (24-27 DHJETOR 1998) - VERSIONI I
MEMOAREVE TË LUFTËTARËVE TË ZONËS OPERATIVE TË
LLAPIT**

Kujtimet e luftëtarëve ndër luftëra, iu kanë shërbyer studiuesve të fushave të ndryshme, përfshirë edhe studiuesit e historisë. Gjatë luftës së viteve 1998-1999, Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) zhvilloi luftime e operacione që karakterizohen me jehonën dhe peshën e tyre në opinionin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar. Një ndër betejat më të njohura është ajo e Llapashticës, e zhvilluar më 24-27 dhjetor 1998 ndërmjet forcave të UÇK-së dhe forcave ushtarako-policore serbe. UÇK-ja në këtë betejë, pos që u përballë me forca të shumta serbe, si ato ushtarako-policore dhe paraushtarake u përballë edhe me të ftohtit me ngrica të larta.

Në këtë punim, faktet historike rreth betejës shoqërohen me memoaret e stafit komandues dhe luftëtarëve pjesëmarrës. Kjo problematikë i është nënshtruar analizës dhe krahasimit në kohë dhe hapësirë. Informacionet mbi Betejën e Llapashticës janë siguruar përmes teknikës së intervistës, përmes bashkëbisedimit dhe rrëfimit personal të luftëtarëve. Në veçanti, këto informacione ballafaqohen me deklaratat dhe intervistat e krerëve të ZOLL-it dhënë shtypit shqiptar në Kosovë gjatë gjysmës së dytë të dhjetorit 1998. Në tërësi, kur deklaratat dhe intervistat krahasohen dhe analizohen me kujdes në raportin e tyre me memoaret e sotme, rezulton se janë në korrelacion të drejtë me njëra-tjetrën dhe korrespondojnë me realitetin e kohës. Nga ky këndvështrim, synohet e vërteta historike mbi Betejën e Llapashticës.

Shikuar në aspektin historik, në kuadër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe luftës çlirimtare, Zona Operative e Llapit, me strukturimin, organizimin, përgatitjen, shtrirjen dhe komandimin, është vlerësuar lart

nga strukturat e Shtabit të Përgjithshëm dhe studiues të ndryshëm.

Deri më sot, rreth Zonës Operative të Llapit ka botime nga autorë fushash të ndryshme, por subjekti studimor i tyre kryesisht ka qenë organizimi ushtarak, ndarja e përgjegjesisë territoriale mes brigadave dhe njësiteve, e fare pak ose më mirë të themi aspak nuk i kanë kushtuar studime organizimit, bashkërendimit strategjik dhe betejave në ZOLL.

Zona Operative e Llapit gjatë luftës një-vjeçare zhvilloi disa beteja, luftime e operacione që karakterizohen me jehonën dhe peshën e tyre jo vetëm tek opinioni i brendshëm, por edhe tek ai ndërkombëtar. Betejat më të njohura ishin: Beteja në Grykën e Kaçandollit (15-18 shtator 1998), Beteja e Llapashticës (24-27 dhjetor 1998), Beteja e Peranit (9 janar 1999), Beteja e Majacit (27 janar 1999) Beteja e marsit (24-27 mars 1999), Beteja e Prapashticës (7 prill 1999), Beteja e Surdullit (15-16 prill 1999), Beteja e Marecit (18 prill 1999), Beteja e prillit (18-19 prill 1999) dhe Operacioni për tërheqjen dhe mbrojtjen e të plagosurve (25 prill deri më 13 maj 1999).

Padyshim, një ndër betejat më të njohura është Beteja e Llapashticës, e cila është zhvilluar nga 24-27 dhjetor 1998. Me organizimin në fushëbetejë, komandim-kontrollin e stafit, pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë në luftime të të gjitha strukturave të Zonës dhe vullnetarëve civil nga anë të ndryshme të Llapit dhe Gollakut, e mësojmë këtë betejë si një shembull rreth luftës së domosdoshme të popullit shqiptar në Kosovë.

Qëllimi dhe synimi i këtij punimi është pasqyrimi i gjendjes pas Betejës së Kaçandollit, i zhvillimeve të gjithanshme para Betejës së Llapashticës në ZOLL, riorganizimin strategjik, shtrirjen e ZOLL-it në pjesën perëndimore, provokimet e forcave serbe, fushëbetejën dhe qëllimet e palëve ndërluftuese, luftimet në betejë, bilancin e luftimeve si dhe rëndësinë e saj në aspektin historik dhe ushtarak.

Në përgatitjen e këtij punimi janë shfrytëzuar gazeta ditore (vendore dhe ndërkombëtare) dhe kryesisht intervista me luftëtarë, pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në betejë. Sfidë e madhe ka qenë mungesa e dokumenteve autentike, e cila më ka detyruar që gjatë punës kërkimore, të marrim për bazë informacionet apo bashkëbisedimet me ish-drejtuessit dhe anëtarët e organeve komanduese, të niveleve të ndryshme, me theks të veçantë ato të pjesëmarrësve në betejë. Në disa raste deklaratat, intervistat dhe memoaret e luftëtarëve në lidhje me ngjarjet dhe rrethanat, kanë qenë kontradiktore për shkak të distancës kohore. Në pikëpamje metodologjike, gjatë punës kërkimore-shkencore është përdorur metoda hulumtuese (intervista dhe bashkëbisedimi), analitike dhe induktive. Kështu, materiali burimor

autentik si dhe ai periodik është studiuar dhe zbërthyer me qëllim që të vijmë te një e vërtetë, e cila mundëson rikonstruktimin e subjektit rrjedhës.

Kësisoj, përkundër rezultateve të arritura në këtë studim, hulumtimet e mëtejme shkencore në të ardhmen do të sjellin burime të reja me interes për këtë problematikë.

Riorganizimi strategjik i Zonës Operative të Llapit (shtator-dhjetor 1998)

Komanda e Zonës Operative të Llapit (ZOLL), pas Betejës së Kaçandollit (15-18 shtator 1998), hartoi strategjinë e re të kundërvënies ndaj forcave serbe.* Mbi bazën e saj, synohej zgjerimi i territoreve të kontrolluara, vendosja dhe fortifikimi i pozicioneve parësore dhe dytësore të luftimeve, pozicionimi përgjatë magjistrales Podujevë-Prishtinë, përgatitja e njësiteve speciale dhe intervenuese, planifikimi i mbështetjes me artileri dhe gatishmëria për kalimin nga lufta guerile në luftën frontale dhe anasjelltas, në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë në luftë. ZOLL, mbi këto analiza si dhe shtrirjes së përgjegjësive territoriale të saj, kishte ndërtuar një sistem të komandim-kontrollit, kishte hartuar plane dhe programe për shtrirje të njësiteve të lidhura për territorin sipas përgjegjësive, kishte hartuar plane për trajnim, si dhe kishte hartuar

* Kosova deri më 18 nëntor të vitit 1998 ishte një Zonë Ushtarake e UÇK-së, e organizuar në shtatë (7) nënzona operative (NZO): NZO e Drenicës, NZO e Pashtrikut, NZO e Dukagjinit, NZO e Shalës, NZO e Llapit, NZO e Neredimes (Nerodimes) dhe NZO e Karadakut. Më 18 nëntor Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së merr vendimin për kalimin nga organizimi i nënzonave operative, në zona operative të UÇK-së. Për nga strukturimi dhe organizimi në terren, krahasuar me organizimet e tjera ushtarake, zonat operative të UÇK-së kishin një organizim dhe strukturë të përafërt të një divizioni standard ushtarak. Sipas vendimit të 18 nëntorit të vitit 1998, zonat operative (ZO) të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës janë: ZO e Drenicës (zona e parë), ZO e Pashtrikut (zona e dytë), ZO e Dukagjinit (zona e tretë), ZO e Shalës (zona e katërt), ZO e Llapit (zona e pestë), ZO e Neredimes (Nerodimes) (zona e gjashtë) dhe ZO e Karadakut (zona e shtatë). Ndarja e përgjegjësive territoriale të zonave operative ishte në përputhje me ndarjen strategjike të veprimit të UÇK-së, gjithnjë të sinkronizuara dhe në bashkëpunim ndërmjet zonave, në mbështetje dhe në veprime luftarake të përbashkëta. Gjeografikisht, Zona Operative e Llapit (ZOLL) shtrihej në pjesën verilindore të Kosovës. Ajo kufizohej: në verilindje me Serbinë, në juglindje me Zonën Operative të Karadakut, në jug me Zonën Operative të Neredimes, në jugperëndim me Zonën Operative të Drenicës dhe në veriperëndim me Zonën Operative të Shalës. Më gjerësisht: Skender Zhitia, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës-Zona Operative e Llapit*, Prishtinë: Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, 2008, f. 29-44.

dokumentacione shitesë që avancojnë luftëtarin dhe zonën në tërësi për veprimet e mbrojtjes dhe luftës çlirimtare.¹

Bazuar në strategjinë e re, ZOLL ishte mobilizuar në planifikimin, organizimin e shtrirjes dhe mbulimit të territorit të kontrolluar nga njësitet e saj. Në atë kohë zhvilloheshin kontakte me popullatën rreth bashkëpunimit dhe mobilizimit, vizitoheshin pika strategjike në tërë territorin e përgjegjësisë dhe bëheshin analiza dhe konstatime rreth mundësisë së përbushjes së strategjisë luftarake.² Në këtë kontekst, u hartuan planet e pozicionimit me fortifikime të forcave dhe mjeteve luftarake në mbrojtje të pjesës së ZOLL-it.³ Bazuar në planin e brigadave filloi ndërtimi i strehimoreve, sigurimi i objekteve për vendosjen e ushtarëve, sigurimin e mjeteve dhe kuzhinave për përgatitjen e ushqimit. Gjithashtu u caktuan ekipe të logjistikës në nivel brigade për furnizim me ushqim të të gjitha vend-pozicioneve, koordinimin maksimal të veprimeve taktike-luftarake, ndarjen e armatimit sipas planit dhe sipas pozicioneve, si dhe vazhdimin e stërvitjeve me ushtarët dhe fillimin e shtrirjes së njësiteve të brigadave sipas planit të 11 tetorit 1998.⁴

Analiza disaditore e pozicioneve të forcave ndërluftuese dhe konfiguracionit të terrenit, krijoi mundësinë e shtrirjes së njësiteve të Brigadës 151 “Zahir Pajaziti” dhe Brigadës 152 “Shaban Shala” në pozicionet e reja dhe strategjike. Në fund të tetorit dhe fillim të nëntorit 1998, Komanda e Zonës kishte arritur të shtrinte njësitet e Brigadës 151 dhe 152 në vijën e parë frontale, duke mbuluar plotësisht pjesën perëndimore të ZOLL-it. Kështu, nga kjo kohë Brigada 151 “Zahir Pajaziti” shtrihej nga fshati Llapashticë e Epërme në jug e deri në fshatin Tashec me thellësi deri në qafën e Kaçandollit, ndërsa Brigada 152 “Shaban Shala” shtrihej nga fshati Lupç i Poshtëm në jug e deri në fshatin Llapashticë e Epërme në veri dhe në thellësi deri në fshatin Popovë.⁵

Në rrethanat e krijuara edhe komanda e ZOLL-it me njësitet pranë komandës, lëvizi nga fshati Buricë në fshatin Llapashticë e Epërme. Pra, Brigada 151 “Zahir Pajaziti” dhe Brigada 152 “Shaban Shala” u shtrinë në një perimetër prej rreth 30 kilometrash, që i ngarkonte me nivel më të lartë

¹ Intervistë me Rustem Mustafën, Komandant i ZOLL-it, Kadri Kastratin, Zëvendëskomandant i ZOLL-it, Nuredin Ibishin, Shef i Shtabit të ZOLL-it, Idriz Shabanin, Komandant i Brigadës 152 “Shaban Shala”, mars-prill 2022.

² Intervistë me Muhamet Latifin, Komandant i Mbrojtjes Civile në ZOLL, mars-prill 2022.

³ Intervistë me Nuredin Ibishin, shkurt 2022.

⁴ Intervistë me Kadri Kastratin, janar 2022.

⁵ Intervistë me Nuredin Ibishin dhe Idriz Shabanin, mars-prill 2022.

të kujdesit dhe përgjegjësisë ushtarake përballë forcave serbe. Zhvendosja e Komandës së zonës dhe brigadave nga njëri fshat në tjetrin, nënkuptonte se UÇK-ja në ZOLL gëzonte përkrahje të veçantë të popullit shqiptar në luftën për çlirim.⁶

ZOLL në prag të betejës

Duke filluar nga mesi i nëntorit dhe në fillim të dhjetorit 1998, forcat serbe nisën të grumbulloheshin, të ripozicionoheshin si dhe të defilonin rrugëve lokale dhe në magjistralen Prishtinë-Podujevë. Këto lëvizje sinjalizonin se, forcat pushtuese po cenonin marrëveshjen Richard Holbrooke-Slllobodan Millosheviq, të arritur më 13 tetor 1998.* Andaj, Komanda e Zonës pas analizës së përgjithshme të situatës në rajonin e Zonës, urdhëroi komandantët e dy brigadave, Brigadës 151 “Zahir Pajaziti” dhe Brigadës 152 “Shaban Shala”, që të fillojnë me përgatitjen e planit të ri për kalim në pozicione të reja, gjegjësisht shtrirjen përgjatë magjistrals Prishtinë-Podujevë, si dhe marrjen e masave parapërgatitore për luftime.⁷ Sipas këtij urdhri, Brigada 151 “Zahir Pajaziti” shtrihej nga fshati Obrancë në jug e deri në fshatin Tashec, me thellësi deri në qafën e Kaçandollit, ndërsa Brigada 152 “Shaban Shala” shtrihej nga fshati Lupç i Poshtëm në jug e deri në fshatin Obrancë në veri dhe në thellësi deri në fshatin Popovë.⁸ Kjo lëvizje e forcave ushtarake të ZOLL-it bëri një sensacion dhe krijoi shqetësim të menjëhershëm te forcat pushtuese dhe drejtuesit e Misionit Verifikues të OSBE-së në Kosovë.*

Në rrethanat e sipërpërmendura dhe në prag të fillimit të luftimeve mes forcave të UÇK-së dhe atyre serbe, zona u vizitua nga Shefi i Misionit Verifikues në Kosovë, William Walker. Komandanti i ZOLL-it, Rrustem Mustafa evokon takimin me William Walker, gjatë vizitës në Komandën e Zonës, në gjysmën e dytë të dhjetorit 1998: *“Ishte një takim në të cilin po mbretëronin mospajtimet dhe ne po habiteshim me qëndrimin kërcënues*

⁶ Intervistë me Muhamet Latifin, mars 2022.

* World Socialist Web Site-WSWS, “*The Holbrooke-Milosevic agreement on Kosovo*”, gasur më 3 qershor 2022. Marrëveshja midis të dërguarit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) Richard Holbrooke dhe kryetarit serb Slllobodan Millosheviq, është arritur më 13 tetor 1998 në Beograd. Për më shumë shih: <https://www.wsws.org › articles › 1998/10 › koso-o20>

⁷ Intervistë me Rrustem Mustafën, mars 2022.

⁸ Intervistë me Nuredin Ibishin dhe Idriz Shabani, mars-prill 2022.

* Organization for Security and Co-operation in Europe (OSCE). Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).

dhe presionin që na bënte William Walker. Ai në vazhdimësi po kërkonte tërheqjen e njësiteve tona në pozicionet e fundit të tetorit - fillimi i nëntorit 1998, në të kundërtën paralajmëronte ofensivën serbe, për të cilën akuzonte UÇK-në për papërgjegjësi... Kështu, takimi u mbyll në një atmosferë të zymtë dhe me qëndrime plotësisht të kundërta”.⁹

Shikuar në kontekstin e zhvillimeve të takimit, Rustem Mustafa ishte i vetëdijshëm për angazhimin dhe rolin e William Walker. Ai nuk ishte kundër tij dhe misionit ndërkombëtar që ai përfaqësonte, por marrja e një vendimi ndryshe nga organizimi strategjik i ZOLL-it, mund të prodhonte reperkusione të pariparueshme, si: ushtarake, politike e morale për UÇK-në. Në aspektin ushtarak, tërheqja nga pozicionet peshonte në favor të forcave ushtarake, policore e paraushtarake serbe, sepse i mundësonte të hynin në brendi të territorit të kontrolluar nga ZOLL-i, ku do të rrezikohej edhe më shumë qëndrueshmëria dhe operimi i tyre. Në aspektin politik, Serbia do ta shfrytëzonte si argument se UÇK-ja po bënte shkelje të marrëveshjeve politike me bashkësinë ndërkombëtare. Ndërsa në aspektin moral, ndikimi do të ishte shumë herë më i dëmshëm, sepse te luftëtarët mund të ndikonte në besimin ndaj stafit komandues rreth planifikimit strategjik dhe operativ, për çka ZOLL do të pësonte goditje strategjike në kuadër të përgjegjësisë së saj.

Mesazhi i Shefit të Misionit verifikues William Walker, mbi të gjitha ishte i qartë dhe tregues se ballafaqimi mes forcave serbe dhe atyre të UÇK-së ishte shumë pranë. Kështu, për shkak të gjendjes së krijuar, Komanda e ZOLL-it kishte urdhëruar ngritjen e nivelit të gatishmërisë dhe vigjilencës. Komandanti i Njësitit “Ulpiana 42”, të Brigadës 152 “Shaban Shala”, Bashkim Qerimi, rreth përgatitjeve dhe gjendjes së gatishmërisë në zonë, mes tjerash thekson: “Disa ditë më parë, në njësitin tonë Komanda e Brigadës 152 “Shaban Shala”, përmes alarmit verifikoi gjendjen e gatishmërisë në Njësitin “Ulpiana 42” dhe konsideroi se njësitit ynë është i përgatitur për çdo ballafaqim me armikun”.¹⁰ Luftëtarët e ZOLL-it gjatë këtij verifikimi treguan nivel të lartë të angazhimit, veprimit dhe gatishmërisë për përballje me forcat kundërshtarë. Verifikimi i gjendjes së gatishmërisë së njësiteve të Zonës ishte tregues i përkushtimit, i seriozitetit, i nivelit të gatishmërisë dhe i përkushtimit të hierarkisë ushtarake.¹¹

⁹ Intervistë me Rustem Mustafën, mars 2022.

¹⁰ Intervistë me Bashkim Qerimin, shkurt 2022.

¹¹ Intervistë me Naser Hysenin, Ajet Poterën, Ismajl Revuçin, Bashkim Qerimin, Zeqir Berishën, Fatmir Sfishtën dhe Refik Jasharin, mars-prill 2022.

Provokimi i forcave ushtarako-policore serbe

Betejës së Llapashticës i parapriu edhe provokimi i forcave serbe ndaj forcave të UÇK-së, më 21 dhjetor 1998, në fshatin Bajçinë. Kolona e forcave serbe prej 17 automjeteve të blinduara në orët e hershme të mëngjesit kishte lëvizur në drejtim të rrugës Podujevë-Kërpimëh. Në rrugë e sipër, ato shmangën rrugën dhe hynë në drejtim të pozicioneve të UÇK-së në fshatin Bajçinë. Komandanti i Brigadës 151 “Zahir Pajaziti”, Nuredin Ibishi, me të marrë informacionin urdhëroi njësitet t’i përgjigjeshin me kundërsulm të armatosur. Dy ditë më vonë, gazeta *Kosova Sot*, e cila nxirrej në Prishtinë, më 23 dhjetor 1998, në artikullin me titull; “Armiku, me tërë arsenalin luftarak, u zbraps në pikën e parë kontrolluese të UÇK-së”, të përgatitur nga autorët N. Elezaj dhe J. Ademaj, gjatë intervistës me Rustem Mustafën, mes tjerash shkroi: “*Ne jemi të vendosur që forcave të armikut, kurdoherë që ato tentojnë të hyjnë në zonën që kontrollojmë ne, t’u përgjigjemi me zjarr. Edhe në rastin e pardjeshëm, forcat serbe kanë tentuar me 17 tanke të hyjnë në Dobratin, pa i provokuar ne, prandaj ne ua kthyem ashtu si e merituan*”.¹² Kjo nënkupton se UÇK-ja në të gjitha dimensionet ishte e gatshme të ballafaqohej me forcat pushtuese. Ndërsa, Naser Hyseni, komandant i Batalionit të parë në Brigadën 151 “Zahir Pajaziti”, konstaton: “*...Armiku u befasua nga qëndresa dhe heroizmi i luftëtarëve tanë. Forcat serbe në pamundësi për të depërtuar më tutje dhe për të shmangur humbjet më të mëdha, u tërhoqën dhe u kthyen në vendstrehimin e tyre në Aeroportin Sportiv të fshatit Dumosh*”.¹³

Bazuar në memoaret e luftëtarëve dhe raportimeve të gazetave të kohës, pos provokimit, më 21 dhjetor 1998, në fshatin Bajçinë, forcat serbe para se të ndërmerrenin ofensivën, prej 22 dhjetorit në vendin e quajtur “Qershitë” e Llapashticës dhe në udhëkryqin për në Llapashticë, kryen vëzhgimin duke lëvizur me njësitet vëzhguese dhe njëkohësisht duke provokuar, me qëllim të zbulimit të pozicioneve të UÇK-së. Një ditë më vonë, gazeta *Kosova Sot*, më 23 dhjetor 1998, në artikullin me titull “Kurrsesi të qetësohet situata”, mes tjerash shkroi: “*Njoftohet, se dje në Podujevë dhe rrethinë, janë vërejtur snajperistë në pika të ndryshme të qytetit... Grupe policësh ndalojnë dhe keqtrajtojnë shqiptarët te punkti i motel “Besianës”, te rruga që shpie për në Llapashticë, te “Qershitë” e Llapashticës, te fabrika e Armaturës dhe në udhëkryqin që shpie për në*

¹² N. Elezaj & J. Ademaj, “Armiku, me tërë arsenalin luftarak, u zbraps në pikën e parë kontrolluese të UÇK-së”, *Kosova Sot*, Prishtinë, e mërkurë, 23 dhjetor 1998, f. 5.

¹³ Intervistë me Naser Hysenin, mars 2022.

Kërpimeh...”¹⁴ Zhvillimet në terren, takimi i Rrustem Mustafës me William Walker dhe tërheqja e vërejtjes, lëvizjet e forcave serbe, provokimi i tyre (21 dhjetor 1998) në fshatin Bajçinë, si dhe incizimet dhe vëzhgimet e forcave serbe në terren (22 dhe 23 dhjetor 1998), ishin shenja paralajmërimi se së shpejti do të fillonte ofensiva e tyre kundrejt pozicioneve të ZOLL-it.

Përkufizimi gjeografik i betejës dhe qëllimi i forcave ndërluftuese

Beteja është e njohur në opinion si Beteja e Llapashticës, por në realitet operacioni luftarak është zhvilluar në një perimetër më të gjerë, rreth 8 kilometra, duke filluar nga pjesa jugperëndimore; fshati Kunushec, fshati Gllamnik, fshati Llapashticë e Poshtme fshati Obrançë dhe fshati Peran.¹⁵ Përkufizimi gjeografik i fushëbetesë tregon rëndësinë ushtarake të vend-pozicioneve të UÇK-së në ZOLL. Në aspektin e strategjisë ushtarake, ato ishin pozita gjeografike dominuese prej nga përcilleshin lëvizjet e forcave serbe përgjatë magjistrales Prishtinë-Podujevë. Gjithashtu, përmes tyre mundësohej lehtë komunikimi me popullatën, me përfaqësuesit e institucioneve (përfaqësuesit politikë, të shkencës, të kulturës, të konfeksionit dhe medimeve vendore e ndërkombëtare) vendore e ndërkombëtare, si dhe organizatave të tjera me interes.

Forcat ndërluftuese në betejë kishin qëllime krejtësisht të kundërta. Forcat ushtarake, policore dhe paraushtarake (me një komandë të vetme) serbe kishin planifikuar që me sulme të rrufeshme t’i godisnin forcat e UÇK-së në ZOLL, të cilat kishin kryer shtrirjen përreth qytetit të Podujevës nga drejtimi jugperëndimor dhe pas futjes nën kontroll të këtyre pozitave të ripozicionoheshin në “Tabë” të Llapashticës, vend strategjik

¹⁴ *Kosova Sot*, “Kursesi të qetësohet situata”, Prishtinë, e mërkurë, 23 dhjetor 1998, f. 6.

¹⁵ Intervistë me Rrustem Mustafën, Kadri Kastratin, Ismajl Revuçin, Ajet Poterën, Refik Jasharin dhe Xhevdet Fejzullahun, prill-maj 2022; *Koha Ditore*, “Luftime të rrepta në fshatrat në perëndim të Podujevës”, Prishtinë, e premte, 25.12.1998, f. 2. Në këtë artikull, ndër të tjerash raportohej: “*Fshatrat Obrançë, Llapashticë, Kunushec, Buricë e fshatra tjera në anën e djathtë të rrugës Podujevë-Prishtinë, janë goditur me artileri të rëndë nga forcat serbe. Në sulm kanë marrë pjesë tanke e autoblanda ushtarake, autoblanda policore e tjera*”. Fshati Llapashticë e Poshtme kufizohet me qytetin e Podujevës dhe ndodhet në jugperëndim të saj. Ky fshat ka një distancë prej 3-4km nga qendra e qytetit të Podujevës. Fshati Obrançë shtrihet 1-3km në pjesën perëndimore të qytetit të Podujevës. Fshati Gllamnik shtrihet rreth 5km në jugperëndim të qytetit të Podujevës. Fshati Kunushec shtrihet 7km në pjesën jugore të Podujevës. Për më shumë shih: Jusuf Osmani, *Krimet e Serbisë në Kosovë, 1998-1999*, Libri 2, Prishtinë: Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, 2010, f. 99, 102, 95, 97.

prej nga mund të bëhej vëzhgimi dhe përkrahja maksimale e njësiteve në dy drejtimet, fshati Obrançë dhe fshati Gllamnik.* Veç kësaj, synohej pamundësimi i forcave të UÇK-së për kontrollin e territorit dhe pjesëve urbane të qytetit si dhe spastrimi etnik i popullatës shqiptare. Kështu, forcat serbe, përfundimisht tentonin rrethimin dhe shkatërrimin e komandës së ZOLL-it.¹⁶

Ndërsa, shikuar në strategjinë e veprimit dhe organizimit në ZOLL, qëllimi parësor në Betejën e Llapashticës ishte: lufta çlirimtare, mbrojtja e pozicioneve, mbrojtja e popullatës nga krimet e forcave serbe, mbajtja nën kontroll e magjistrales Merdar-Prishtinë dhe pengimi i pushtuesit gjatë lëvizjeve të forcave dhe mjeteve luftarake të sjella nga Serbia. Gjithashtu, kishin për qëllim që Podujeva si qytet të mbahej nën mbikëqyrje, si dhe të bëhej përgatitja e terrenit për krijimin e zonave të lira në pjesën perëndimore të magjistrales Merdar-Prishtinë.¹⁷

Forcat ndërluftuese dhe arsenali i përdorur në betejë

Forcat serbe në betejë ishin kombinim i forcave ushtarake, policore e paraushtarake. Kadri Kastrati, Nuredin Ibishi dhe Idriz Shabani, lidhur me forcat numerike serbe të përfshira në betejë mendojnë se ato “*ishin rreth 1 500 forca komplekse dhe të kombinuara, policore, ushtarake e paramilitare*”, të cilat ishin të komanduara nga strukturat e përgjithshme komanduese të forcave të rregullta ushtarake dhe ishin të pajisur me armatimin më të sofistikuar të kohës dhe kalibrash të ndryshme, duke filluar nga ato të këmbësorisë, të blinduara e deri tek ato ajrore.¹⁸ Në rrethanat e kohës dhe forcave ndërluftuese, armatimi i përdorur nga forcat

* Forcat serbe, sipas marrëveshjes Hollbruk - Millosheviq, e arritur më 13 tetor 1998, ishin larguar nga ky pozicion.

¹⁶ Intervistë me Rrustem Mustafën, Kadri Kastratin, Nuredin Ibishin dhe Idriz Shabanin, mars-prill 2022.

¹⁷ Intervistë me Rrustem Mustafën, mars 2022.

¹⁸ Christophe Chatelot “Les forces serbes interviennent violemment dans le nord du Kosovo”, *Le Monde*, Paris, e shtunë, 26 dhjetor 1998; Paul Welch, “Raports on Friday’s fighting”, British Broadcasting Corporation (BBC) News, London, e shtunë 26 dhjetor 1998; *Koha Ditore*, “Clark: “Armata serbe e ka thyer premtimin e saj””, Prishtinë, e hënë, 28 dhjetor 1998, 3; Nazmi Elezi, “Intervistë me zëvendëskomandantin e Zonës Operative të Llapit-komandant “Daja”, *Kosova Sot*, Prishtinë, e enjte, 31 dhjetor 1998, f. 14; Intervista me Kadri Kastratin, Nuredin Ibishin dhe Idriz Shabanin, mars-prill 2022.

pushtuese në betejë ishte i pakrahasueshëm dhe një avantazh i madh karshi armatimit të përdorur nga forcat e UÇK-së në ZOLL.¹⁹

Në Betejën e Llapashticës numri i ushtarëve të UÇK-së ishte shumë herë më i vogël se sa ai i ushtrisë serbe. Në Betejë UÇK-ja iu kundërvu me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë armikut me rreth 300 forca ushtarake që ishin luftëtarë të Brigadës 151 “Zahir Pajaziti”, të Brigadës 152 “Shaban Shala”, të Njësitit Special të Zonës “Komando”, të Njësitit të Muharrem Ismajlit, të Mbrojtjes Civile, Njësi i fshatit Revuç, fshatit Sylevicë “Ulpiana 55”, fshatit Obrançë dhe fshatit Velikarekë, njësitet vëzhguese nga terreni “Kështjella 26”, “Kështjella 27”, “Kështjella 32”, “Kështjella 33” dhe vullnetarë nga rajoni i ZOLL-it.²⁰

Në betejë, pos që kishte një diferencë të madhe midis forcave të angazhuara, ndryshimi ishte edhe në arsenalin e armatimit të përdorur. UÇK-ja në betejë përdorte kryesisht armatim këmbësorie.²¹ Numri i forcave dhe armatimi i përdorur tregojnë se në Betejën e Llapashticës është zhvilluar një luftë e pabarabartë. Mirëpo, te luftëtarët e UÇK-së ka mbizotëruar ideali i lartë, ndjenja e përgjegjësisë historike dhe mishërimi për t’u flijuar për çlirimin e Kosovës.

¹⁹ Sipas Kadri Kastratit: “*Forcat e armikut gjatë kësaj ofensive kanë përdorur armatime të kalibrave të ndryshëm dhe makineri të blinduar, si: tanket “T 55”, “T 72”, transportierë “BVP - 80”, “OTM- 60”, “Pragat” - dygrykëshet të kalibrit 30 mm (të ndaluara me konventa ndërkombëtare), minahedhësit 120, 82 dhe 60 mm, transportierët e tipit “BOV”, si dhe teknikë tjetër të modifikuar, mitralozat 12.7 mm, 7.62 mm, si dhe topat 120 mm. Përveç teknikës luftarake të përmendur, armiku përdori edhe mjetet e elektroteknikës (radio- pengesat, radio-llokatorët) dhe mjete tjera për përgjimin dhe bllokimin e radiolidhjeve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës*”. Më gjerësisht: Intervistë me Kadri Kastratin, mars 2022.

²⁰ Intervistë me Rustem Mustafën, Idriz Shabanin, Ajet Poterën, Bashkim Qerimin, Refik Jasharin, Fatmir Sfishtë, Sadat Cakiqin dhe Kadri Bllacën, mars 2022.

²¹ Sipas stafit komandues të ZOLL-it: “*Forcat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, gjatë kësaj ofensive kanë përdorur armatime të lehta këmbësorie të kalibrave të ndryshëm, si: mitraloz 12. 7, mitraloz M53 sharc, mitraloz M72mm, mitraloz 100 Kinez, mitraloz PKT 7. 62mm, pushkëmitraloz – 100, pushkëmitraloz – 84 pushkë M – 48, pushkë gjysmë automatike, pushkë automatike hekler, pushkë snajperike 7. 9mm dhe 12.5, pushkë automatike kallashnikov model AK-74, pushkë 20-she, pushkë M-43, pushkë gjuetie, raketahedhës i dorës M-80 “Zola”, mortaja dore antiblind 150 dhe 500-she, mina antitanke, minahedhës 60, 82 dhe 120mm, top pa dridhje 76 mm, OSA mortaja krahu 90mm, pushkë angleze, vinçesterë, tomson amerikan, të ashtuquajturat nitroglicerina, minat antitank MTK, bomba dore, mina artizanale, revole, thika etj*”. Më gjerësisht: Intervistë me Nuredin Ibishin, Idriz Shabanin, Ajet Poterën, Ismajl Revuçin dhe Naser Hysenin, prill 2022.

Fillimi i luftimeve

Ishte ditë e enjte e 24 dhjetorit 1998, ditë dimri i acartë dhe me mjegull, e cila kishte mbuluar Luginën e Llapit. Rrjedhimisht, forca të shumta ushtarake, policore e paraushtarake serbe, me pajisje moderne të blinduara, nga drejtime të ndryshme të vendqëndrimeve të tyre, lëvizën drejt pozicioneve të UÇK-së në ZOLL. Zhurma e automjeteve të rënda dhe të blinduara filloi të qetësohet pas fillimit të pozicionimit të tyre te fabrika e tullave (tjegullorja), në rrugën Podujevë-Llapashticë (drejtimi i “Tabeve”), te “Qershitë” e Llapashticës dhe në Gllamnik. Forcat pushtuese fillimisht bënë vëzhgimin e terrenit dhe pas shtrirjes së formacioneve të tyre në perimetrin e fushëbetejës, nisën lëvizjet në drejtim të pozicioneve të UÇK-së.²²

Përballë tyre, në pozicionet e para dhe në istikame po qëndronin luftëtarët e ZOLL-it, të cilët ishin mobilizuar që në orët e hershme të mëngjesit, pasi kishin pranuar njoftimin nga vëzhguesit në vend-pozicione.²³ Sulmet filluan rreth orës 06:30 të mëngjesit në tri drejtime: në drejtimin verior (fshati Obrancë), drejtimi qendror (apo drejtimi kryesor “Tabë” të Llapashticës së Poshtme) dhe drejtimi jugor (fshati Gllamnik).

²² Intervistë me Bashkim Qerimin, Behram Havollin, Xhevat Shaqirin, Sadat Cakiqin dhe Kadri Bllacën, mars-prill 2022.

²³ Sipas Kadri Kastratit, Nuredin Ibishit, Idriz Shabanit, Ismajl Revuçit, Ajet Poterës, Refik Jasharit, Fatmir Sfishtës, Xhevdet Fejzullahut dhe Sadat Cakiqit: “Në “Tabë” të Llapashticës ishte i vendosur njësit i Brigadës 152 “Shaban Shala”, “Ulpiana 39” me komandant Bedri Ahmetin, kurse në krahun e majtë apo në anën jugore të “Tabeve” ishin njësitet tjera të Brigadës 152 “Shaban Shala”. Në fshatin Llapashticë e Poshtme, te lagja “Murataj” ishte njësit “Ulpiana 42” me komandant Bashkim Qerimin. Në fshatin Gllamnik, te lagja “Kërtokët” ishte njësit “Ulpiana 40” me komandant Rifat Malokun. Te çezma ishte njësit “Ulpiana 41” me komandant Avdullah Hazirin. Te mëhalla e Lahajve ishte njësit “Ulpiana 52” me komandant Islam Halitin dhe në fshatin Kunushec te varret ishte njësit “Ulpiana 48” me komandant Zeqir Berishën. Në krahun e djathtë apo verior, ishin të vendosura njësitet e Brigadës 151 “Zahir Pajaziti”. Në fshatin Obrancë, te lagja “Duriqët” ishte njësit “Ulpiana 36” me komandant Isa Dergutin, ndërsa tek udhëkryqi (te shkolla) ishte njësit “Ulpiana 35” me komandant Refik Shalën. Në fshatin Peran, te varrezat ishte njësit “Ulpiana 34” me komandant Sevdaim Ramadanin. Në prapavijë të tyre qëndronin njësitet pranë Shtabit të ZOLL-it, si: Njësit Special “Komando” i komanduar nga Sabit Neziri, Policia Ushtarake e komanduar nga Nazif Mehmeti dhe Njësit “Dardania 109” i komanduar nga Muharrem Ismajli”. Më gjerësisht: intervistë me Kadri Kastratin, Nuredin Ibishin, Idriz Shabanin, Ismajl Revuçin, Ajet Poterën, Refik Jasharin, Fatmir Sfishtën, Xhevdet Fejzullahun dhe Sadat Cakiqi, mars-prill 2022.

Në drejtimin verior të fushëbetejës, gjatë lëvizjes drejt pozicioneve të UÇK-së, këto forca pandërprerë granatonin dhe mitralonin.²⁴ Luftëtarët, nga istikamet e tyre, me vigjilencë të lartë prisnin që forcat serbe t'i afroreshin rrezes së efektshme të armëve antiblind. Sipas urdhit, me arritjen e forcave serbe ballë për ballë, filloi lufta e cila përkundër që kishte disproporcion të thellë, luftëtarët e UÇK-së, me zjarrin e armëve antiblind arritën t'i ndalnin forcat serbe, duke iu asgjësuar tanke dhe mjete të tjera të blinduara si dhe humbje ushtarake.²⁵ Forcat serbe, të befasuara me kundërvënien e luftëtarëve të UÇK-së, bënë një tërheqje taktike me qëllim të riorganizimit dhe rikoncetrimin të zjarrit në betejë.²⁶ Rifillimi i luftimeve u shoqërua me një kundërpërgjigje me arsenalin e tyre të të gjithë kalibrave që kishin dislokuar përballë vijës frontale mes forcave ndërluftuese. Ato identifikuan dhe vënë në shënjestër të gjitha pozicionet e zjarrit të UÇK-së dhe rifilluan granatimin e tyre, shtëpitë e banorëve dhe popullsinë civile, lagjet “Kastratët”, “Duriqët” e “Sllatinët”, si dhe në thellësi të fshatit Llapashticë, që kontrolloheshin nga UÇK-ja.²⁷

Rezistenca e luftëtarëve të UÇK-së ishte këmbëngulëse, andaj ushtria serbe ndërroi taktikën duke e përqendruar sulmin në një pozicion të vetëm, në “Tabet” e Llapashticës e deri te lagja “Kastratët”. Ushtria serbe futi në luftim një kompani tankesh dhe rreth 30-35 mjete të blinduara, duke u përpjekur të merrte krahun e djathtë, krahun e majtë dhe shpinën e pozicioneve mbrojtëse të ZOLL-it. Gjatë luftimeve, pos granatimeve me kalibra të ndryshëm të forcave ushtarake, përballë dhe mbi pozicionet e UÇK-së gjuanin edhe snajperistë, për të mos lënë nga shënjestra shtëpitë, ndërtesat dhe lartësitë më dominuese, nga mund të shikoheshin e kontrolloheshin lëvizjet e luftëtarëve të UÇK-së.²⁸ Pas disa orë luftimesh, në krahun e majtë (drejtimi Obrancë - “Tabet” e Llapashticës) të fushëbetejës bien luftëtarët e parë të kësaj beteje, komandanti i njësitit

²⁴ Sipas Nuredin Ibishit, Idriz Shabanit, Sadat Cakiqit, Kadri Bllacës: “Në drejtimin verior të fushëbetejës, fshati Obrancë (lagjet “Kastratët”, “Sllatinët” dhe “Duriqët”) - “Tabet” e Llapashticës së Poshtme, forcat serbe të cilat ishin të vendosura në fabrikën e tullave (tjegullorja), në orët e hershme të mëngjesit filluan sulmin drejt pozicioneve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Forcat serbe ishin të pajisura me artileri të rëndë (tanke e autoblanda)”. Më gjerësisht: intervistë me Nuredin Ibishit, Idriz Shabanit, Sadat Cakiqit, Kadri Bllaca, mars-prill 2022.

²⁵ Intervistë me Sadat Cakiqin, Kadri Bllacën dhe Refik Jasharin, prill 2022.

²⁶ Intervistë me Sadat Cakiqin dhe Kadri Bllacën, prill 2022.

²⁷ Intervistë me Sadat Cakiqin, prill 2022.

²⁸ Intervistë me Sadat Cakiqin, prill 2022.

“Ulpiana 36”, Isa Dërguti dhe luftëtarët Lulëzim Jashari, Miftar Zejnullahu dhe Skender Zejnullahu.²⁹

Gjithashtu, në drejtimin kryesor, forca të shumta serbe, të cilat ishin pozicionuar në rrugën Podujevë-Llapashticë (drejtimi i “Tabeve”), rreth orës 07:00 të mëngjesit, filluan sulmet me granata drejt pozicioneve të luftëtarëve të UÇK-së. Granatimet nga minahedhës kalibrash të ndryshëm, si dhe nga armët tjera të artilerisë, shtriheshin në një rreze të gjerë veprimi. Luftëtarët e njësitit “Ulpiana 39” të komanduar nga Bedri Ahmeti, që në orët e hershme të mëngjesit ishin pozicionuar në istikamet që shtriheshin përgjatë vijës frontale, nga “Tabet” e Llapashticës e deri te “Qershitë” e Llapashticës. Ata iu kundërvunë sulmeve të intensifikuara të forcave kundërshtarë duke u shkaktuar atyre humbje njerëzore dhe materiale.³⁰

Gjatë këtyre luftimeve, luftëtarët e UÇK-së treguan heroizëm të madh. Isa Havolli nuk lëvizi nga pozicioni ku qëndronte prej javësh. Ai u tha bashkëluftëtarëve: *“Unë nuk tërhiqem së gjalli nga këtu!”*³¹ Behram Havolli, luftëtar i Njësitit “Ulpiana 39” i Brigadës 152 “Shaban Shala”, lidhur me heroizmin e Isa Havollit, thekson: *“Ne hapëm zjarr pareshtur kundër forcave serbe. Tanket filluan të shpërndaheshin në drejtime të ndryshme me cak të vetëm pikën dominuese “Tabet” e Llapashticës. Ato shtinin pandërprerë në drejtimin tonë dhe granatonin në thellësi pozicionet tona. Ne arritëm t’i ndalim dhe shkatërrojmë dy tanke, kurse disa të tjera hipën deri në afërsi të pozicioneve tona. Në ato momente kemi vërejtur Isa Havollin, i cili me zollë po gjuante në drejtim të tankeve dhe derisa po sulej drejt tyre vritet nga mitralimet e një tanku që po lëvizte nga drejtimi i fshatit Obrançë”*.³² Por, përkundër kësaj, luftëtarët e UÇK-së përballë makinerisë moderne ushtarake u detyruan të tërhiqeshin më në thellësi (në pozicione tjera), me qëllim të riorganizimit dhe rifillimit të kundërsulmit. Kështu, forcat serbe arritën të vendosen në pikën strategjike “Tabet e Llapashticës”.

Në të njëjtën kohë, luftime me intensitet të lartë po zhvilloheshin edhe te pozicionet e Njësitit “Ulpiana 42”, i cili ishte i vendosur në Llapashticë të Poshtme, lagjet “Muratët” dhe “Muharremët”, afër

²⁹ Intervistë me Refik Jasharin, mars 2022.

³⁰ Haqif Mulliqi, “Si u zhvillua beteja e Qafës së Kaçandollit dhe ajo e funddhjetorit në Llapashticë?”, *Kombi*, Prishtinë, 23 shkurt 2000, f. 50-53; Intervistë me Behram Havollin, Naim Miftarin, Bedri Hakiqin, Sami Cakiqin, Eset Sylën dhe Xhevat Shaqirin, mars 2022.

³¹ Behram Havolli, Naim Miftari, Bedri Hakiqi, Sami Cakiqi dhe Xhevat Shaqiri, intervistë dhënë autorit, mars 2022.

³² Behram Havolli, intervistë dhënë autorit, mars 2022.

lokacionit të quajtur “Te Mella”. Pas përgatitjeve fillestare, forcat serbe përmes armëve artilerike të kalibrave të ndryshëm (minahedhës), filluan sulmet në drejtim të pozicioneve të luftëtarëve të ZOLL-it. Pozita gjeografike ku ishte i vendosur Njësi “Ulpiana 42”, kishte konfigurimin e një lugine me kodrina të vogla, që armikut nuk i përshtatej vendosja e tankeve, sepse rrezikoheshin lehtësisht nga zjarri i armëve. Kështu, forcat serbe filluan granatimet dhe lëvizën mjetet e blinduara drejt pozicioneve të ZOLL-it.³³

Rënia e pozicioneve të vendi “Tabet” e Llapashticës krijoi vështirësi për ZOLL-in në fushëbetejë. Istikamet e njësitit “Ulpiana 42” dolën jashtë përdorimit dhe kjo ndryshoi strategjinë e luftës në betejë. Komandanti i Batalionit të Parë, Ajet Potera, urdhëroi zhvendosjen në pozicione të tjera (më në thellësi), ku lufta po zhvillohej në distanca shumë të afërta dhe nga shtëpitë ku ishin identifikuar podrume, të cilat krijojnë siguri nga granatimet e forcave serbe.³⁴ Kështu, forcat serbe të këmbësorisë nuk kishin mundësi të depërtonin në drejtim të pozicioneve të luftëtarëve të ZOLL-it, për shkak të qëndresës së lartë. Luftëtari i Njësitit “Ulpiana 42”, Rrahim Berisha, kujton: *“Forcat serbe shpesh tentonin me këmbësori të na sulmonin, por i zbrapsnim vazhdimisht. Ne asnjëherë nuk u lëkundëm nga pozitat tona edhe pse nga i ftohti i madh armët na ngjiteshin për duar”*.³⁵

Në ndërkohë, në drejtim të Gllamnikut, përkatësisht në anën e majtë (krahun jugor) të fushëbetejës, forcat pushtuese, herët në mëngjes ishin pozicionuar në rrugën magjistrale Podujevë-Prishtinë, pikërisht përballë Njësitit “Ulpiana 40” i komanduar nga Rifat Maloku.³⁶ Njësi ishte i vendosur në lagjen “Kërtokët”. Perimetri i luftimeve shtrihej më tej në pjesën jugore, deri në fshatin Kunushec. Forcat serbe nga vend-pozicionimet e tyre filluan të granatonin dhe mitralonin pozicionet e ZOLL-it. Ato, pas granatimeve që zhvilluan, madje edhe ndaj shtëpive të popullatës civile, përparuan në drejtim të pozicioneve të luftëtarëve të ZOLL-it, por nga kundërpërgjigja e tyre u detyruan të tërhiqeshin dhe të riktheheshin në pozicionet fillestare. Gjatë këtyre luftimeve, rreth

³³ Intervistë me Ajet Poterën, Zeqir Sadikun dhe Fatmir Shabanin, prill-maj 2022.

³⁴ Intervistë me Zeqir Sadikun, Rrahim Berishën, Fatmir Shabanin dhe Ilir Latifin, mars-prill 2022.

³⁵ Intervistë me Rrahim Berishën, mars 2022.

³⁶ Intervistë me Rifat Malokun, Shpetim Beselicën, Hasim Blakqorin dhe Lulzim Restelicën, qershor 2022.

mesditës, në fushëbetejë ranë dëshmorë luftëtarët Fatmir dhe Avni Selmani.³⁷

Gjatë luftimeve të pandërprera në mesditë, në të tri drejtimet e fushëbetejës u shfaqën vështirësi si pasojë e granatimeve të forcave serbe. Rrjedhimisht, Komanda e ZOLL-it, urdhëroi tërheqjen e forcave të saj nga tri pozicionet e para, pozicioni në “Tabë” të Llapashticës si dhe dy pozicionet e para anësore (drejtimi Obrancë dhe Llapashticë e Poshtme). Tërheqja ishte veprim strategjik i Komandës së Zonës, me qëllim të futjes në pykë (gjysmërreth) të forcave serbe. Kjo strategji ishte e mbështetur në rrethanat e fushëbetejës dhe mundësitë e pabarabarta në vazhdim për përballje frontale me forcat serbe.³⁸

Tërheqja në pozicionet e dyta (vija e dytë frontale) krijoi mundësinë e riorganizimit në fushëbetejë. Kështu, Komanda e Zonës, urdhëroi sulmin kundrejt forcave serbe në dy drejtime të pozicionuara në “Tabë” të Llapashticës, nga drejtimi (krahu) jugor ku ishin njësitet e Brigadës 152 “Shaban Shala” dhe nga drejtimi (krahu) i veriut ku ishin njësitet e Brigadës 151 “Zahir Pajaziti”.

Sipas urdhrit të komandantit të Brigadës 152 “Shaban Shala”, njësitet në drejtimin (krahun) jugor, ndërmorën sulme të fuqishme ndaj forcave kundërshtare. Sulmet kryheshin nga pozicione dhe drejtime të ndryshme drejt “Tabeve”. Sipas Ajet Poterës, *“me urdhër të Shtabit të Zonës disa herë tentuam që forcat serbe t’i detyronim të tërhiqeshin nga “Tabet” e Llapashticës... Sulmet i kryenim nga pozicionet tona me ekipin e minahedhëseve 82 mm, të mbështetur nga njësite në të dy krahët. Në luftime ishin përfshirë edhe Njësitë Special “Ulpiana 52” i Brigadës 152, që komandohej nga Mensur Hoti, Njësitë “Dardania 109”, që komandohej nga Muharrem Ismajli, si dhe Ali Potera i cili komandonte me Mbrojtjen Civile. Atë dite i shkaktuam dëme të konsiderueshme armikut, ndërsa ne humbëm një pikë të rëndësishme strategjike; “Tabet” e Llapashticës”.*³⁹

³⁷ Intervistë me Sabri Hamitin dhe Hasim Blakqorin, prill-qershor 2022.

³⁸ Haqif Mulliqi, “Si u zhvillua beteja e Qafës së Kaçandollit dhe ajo e funddhjetorit në Llapashticë?”, *Kombi*, Prishtinë, 23 shkurt 2000, f. 52; Intervistë me Kadri Kastratin, mars 2022.

³⁹ Sipas Ajet Poterës, Idriz Shabanit dhe Rifat Malokut: *“Këto njësi në fushëbetejë komandoheshin nga komandanti i Batalionit të parë Ajet Potera (“Ulpiana 39”, “Ulpiana 42”, “Ulpiana 40”, “Ulpiana 41”), Njësitë Special “Ulpiana 52” i Brigadës 152 “Shaban Shala” i komanduar nga Mensur Hoti dhe Mbrojtja Civile e komanduar nga Ali Potera”.* Më gjerësisht: Intervistë me Ajet Poterën, Idriz Shabanin, Rifat Malokun, mars-prill 2022

Sipas urdhrit të Komandës, rreth mesditës, në drejtimin (krahun) e veriut (lagjja “Sllatinët” e fshatit Obrançë), ku ishin të pozicionuara njësitet e Brigadës 151, është bërë riorganizimi dhe ripozicionimi në fushëbetejë.⁴⁰ Më pas rifilluan luftimet me një intensitet të lartë, ku forcat e UÇK-së, me anë të armëve antiblindë, nga një distancë shumë e afërt, shkatërruan disa automjete të blinduara të forcave serbe, të cilat më pas u detyruan të tërhiqeshin. Pas luftimeve, zëvendëskomandanti i Brigadës 151, Arif Muqolli, dha urdhër për pastrim të terrenit dhe organizmin e sulmit ndaj forcave serbe në “Tabë” të Llapashticës.⁴¹ Sulmi i koordinuar mes dy brigadave, për rimarrje të pozitës në “Tabë”, ishte i pasuksesshëm, sepse konfiguracioni i terrenit ishte i përshtatshëm për arsenalin e forcave kundërshtarë që sulmonin ashpër. Në këtë pikë të betejës drejtuesit dhe luftëtarët e ZOLL-it nuk kishin mundësi t’i afroheshin forcave serbe ose t’i fusnin ato nën rrezën e veprimit. Ndonëse aksioni nuk pati sukses, njëkohësisht nuk pati humbje nga radhët e tyre. Kështu, forcat serbe konsoliduan pozicionimin e tyre në pikën strategjike në “Tabë” të Llapashticës.

Që në mbrëmje të 24 dhjetorit 1998, përfaqësues të OSBE-së zhvilluan kontakte me strukturat komanduese të forcave serbe dhe atyre të UÇK-së në ZOLL. Ata kërkonin ndërprerjen e luftimeve dhe respektimin e marrëveshjes Hollbruk-Milloshëviq. Anëtari i Shtabit të ZOLL-it, Sejdi Rama, shef i Zyrës për Informim, kujton: “Më 25 dhjetor 1998, në komandën e Zonës është zhvilluar një nga takimet mes komandantit Rrustem Mustafa dhe përfaqësuesve të OSBE-së. Temë e atij takimi ishte ndërprerja e provokimeve dhe luftimeve të dyanshme. Njëri nga zyrtarët e OSBE-së na tha: “A jeni të vetëdijshëm se për herë të parë e keni mposhtur ushtrinë jugosllave?””⁴²

Gazeta e përditshme *Kosova Sot*, më 25 dhjetor 1998, në artikullin me titull “Palët kërcënojnë dhe akuzojnë njëra-tjetrën”, mes tjerash shkruan: “UÇK-ja ka paralajmëruar fundin e politikës së përmbajtjes që e ka shpallur gjatë tetorit, kurse forcat e sigurimit kanë njoftuar se do të

⁴⁰ Pas rënies së Isa Dergutit, Refik Jashari emërohet komandant i Njësitit “Ulpiana 36”.

⁴¹ Sipas Refik Jasharit dhe Sadat Cakiqit: “Në drejtimin (krahun) e veriut (lagjja “Sllatinët” e fshatit Obrançë), ishin të pozicionuara njësitet e Brigadës 151 (“Ulpiana 36” dhe “Ulpiana 35”), që në fushëbetejë komandoeshin nga zëvendëskomandanti i Brigadës 151 “Zahir Pajaziti” Arif Muqolli, Njësi Special i Brigadës 151, “Ulpiana 30” i komanduar nga Fatmir Sfishta, njësi “Ulpiana 36” i komanduar nga Refik Jashari dhe pjesëtarët të Policisë Ushtarake të Zonës”. Më gjerësisht: Intervistë me Refik Jasharin dhe Sadat Cakiqin, mars-prill 2022.

⁴² Intervistë me Sejdi Ramën, prill 2022.

ndërmarrin hapa për të mbajtur të hapur rrugët e Kosovës”.⁴³ Takimet e ndërsjella ishin tregues se tensionet mes palëve ndërluftuese ishin në kulm dhe me mundësi të eskalimit të luftimeve më pas.

Përkundër bisedimeve me përfaqësuesit e OSBE-së, forcat serbe në ditët vijuese, më 25 dhe 26 dhjetor 1998, disa herë tentuan të depërtonin drejt pozicioneve të UÇK-së në ZOLL, për të marrë dhe zgjeruar territorin e kontrollit, por pas kundërpërgjigjes së luftëtarëve të UÇK-së detyroheshin të tërhiqeshin.⁴⁴ Ajet Potera konstaton se *“të gjithë luftëtarët qëndronin në istikame dhe në gatishmëri luftarake. Ka pasur më tepër luftime dhe gjuajtje nga pozicionet, ku shpeshherë armiku bënte tentime të vogla për të zgjeruar e rimarrë territor, por haste në rezistencën e fortë të ushtarëve të UÇK-së”*.⁴⁵ Sulmet serbe, më 25 dhe 26 dhjetor 1998, mbi pozicionet e ZOLL-it ishin një mashtrim i drejtuar ndaj OSBE-së.

Mashtrimi u përcoll në bisedimet te Komanda e Zonës, ku OSBE dëshironte të respektohej dhe të ruhej marrëveshja mes tyre dhe OSBE-së. Lidhur me këto bisedime, më 26 dhjetor 1998, Shtabin e ZOLL-it e vizitoi shefi i Misionit Verifikues të OSBE-së, William Walker. Gazeta *Koha Ditore*, e datës 27 dhjetor 1998, në artikullin me titull *“Z. Uoker nga UÇK-ja kërkoi të përmbahet nga sulmet”*, mes tjerash citoi pjesë nga intervista me komandant *“Dajën”* (Kadri Kastatin): *“Ai kërkoi nga ne që të vetëpërmbahemi dhe të mos provokojmë forcat serbe nëpër rrugët magjistrale. Ne iu përgjigjem atij, se njësitet tona kurrë nuk kanë provokuar dhe nuk kanë sulmuar të parat. Rrugët magjistrale gjithnjë kanë qenë të qarkullueshme. Përkundër asaj se në marrëveshjen Hollbruk-Milloshëviq parashihet që forcat serbe ta lëshojnë Kosovën e jo të hyjnë brenda, ne prapëseprapë nuk kemi sulmuar forcat e tyre gjatë qarkullimit dhe patrullimit të tyre në rrugët magjistrale. Nga z. Walker kemi kërkuar që forcat serbe të tërhiqen nga pozicionet që kanë zënë, në të kundërtën armëpushimi nuk do vlejë më”*.⁴⁶

Përkundër marrëveshjes me OSBE-në, luftime të ashpra vijuan më 27 dhjetor, kur forcat serbe ndërmorën sulm në pozicionet e UÇK-së në fshatin Obrançë. Gazeta *Koha Ditore*, e datës 28 dhjetor 1998, në kryetitullin *“Forcat serbe sulmuan sërish Llapashticën dhe Obrançën”*,

⁴³ *Kosova Sot*, “Palët kërcënojnë dhe akuzojnë njëra-tjetrën”, Prishtinë, e shtunë, 26.12.1998, f. 3.

⁴⁴ *Koha Ditore*, “Forcat serbe sulmuan fshatin Obrançë”, Prishtinë, e hënë, 27 dhjetor 1998, f. 1-2.

⁴⁵ Intervistë me Ajet Poterën, prill 2022.

⁴⁶ *Koha Ditore*, “Z. Uoker nga UÇK-ja kërkoi të përmbahet nga sulmet”, Prishtinë, e diel, 27 dhjetor 1998, f. 3.

bazuar nga burimet e saja në teren mes tjerash potencoi: *“Të dielën duke filluar nga ora 09:30, forcat serbe kanë filluar të shtënë me armë zjarri në drejtim të fshatit Llapashticë. Forcat ushtarake-policore serbe rreth orës 12:00 sulmuan edhe fshatin Obrançë dhe pozicionet e UÇK-së. KMDLNJ-ja njoftonte se granatimet janë shumë të fuqishme, ndërsa forcat e UÇK-së ndodheshin në pozicionet e tyre. Granatimet e forcave serbe kanë pushuar rreth orës 14:00”*.⁴⁷

Fatmir Sfishta, komandant i Njësitit Special “Ulpiana 31” në kuadër të Brigadës 151 “Zahir Pajaziti”, lidhur me luftimet e 27 dhjetorit 1998, evokon: *“Forcat serbe filluan një sulm edhe nga fshati Peran, përkatësisht u sulmua pika mbrojtëse e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila ishte e pozicionuar në udhëkryqin mes fshatit Obrançë dhe fshatit Peran. Kjo pikë ishte vazhdimësi e vijës frontale midis territorit që kontrollohej nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe pjesës nga sulmonin forcat serbe”*.⁴⁸ Gjatë këtyre luftimeve, si pasojë e granatimeve të forcave serbe, më 27 dhjetor 1998, ra heroikisht luftëtari Jetullah Kastrati dhe u plagos për vdekje Remzi Demolli.

Ditë më pas, deklaramet e palëve ndërluftuese ishin tregues se lufta nuk kishte përfunduar dhe do të vazhdonte deri në epilogun e saj: çlirimin e Kosovës sipas pikëpamjes së UÇK-së ose mbajtjen e saj nën pushtim sipas pikëpamjes së forcave serbe. Më 30 dhjetor 1998, e përditshmja *Koha Ditore*, në artikullin me titull “UÇK-ja e gatshme për luftime të reja”, të marrë nga Agjencia Ndërkombëtare e Lajmeve Reuters, mes tjerash citonte Rrustem Mustafën: *“Marrëveshja është arritur me vëzhguesit e OSB-së, e jo me serbët”*. Tutje, ai theksonte se UÇK-ja në ZOLL ishte e gatshme për vijimin e luftimeve kundër forcave pushtuese të Serbisë.⁴⁹ Deklarimi i Rrustem Mustafës konfirmonte gatishmërinë e luftëtarëve në ZOLL për të luftuar deri në çlirimin përfundimtar të Kosovës.

Bilanci i luftimeve

Forcat serbe gjatë mitralimeve dhe bombardimeve dëmtuan dhe shkatërruan infrastrukturën e banimit, kanalizimet, sistemin energjetik,

⁴⁷ *Koha Ditore*, “Forcat serbe sulmuan sërish Llapashticën dhe Obrançën”, Prishtinë, e hënë 28 dhjetor 1998, f. 1-2.

⁴⁸ Fatmir Sfishta, intervistë dhënë autorit, prill 2022.

⁴⁹ *Koha Ditore*, “UÇK-ja e gatshme për luftime të reja”, Prishtinë, 30 dhjetor 1998, f. 2.

pajisje logjistike, automjete, si dhe dëbuan dhunshëm një numër të konsideruar të popullatës civile.

Gjatë betejës dhe në luftime e sipër pati ushtarë të vrarë si nga forcat e UÇK-së dhe nga forcat serbe. Nga Brigada 151 “Zahir Pajaziti” ranë dëshmorë pesë luftëtarë, ndërsa nga Brigada 152 “Shaban Shala” ranë dëshmorë katër luftëtarë.⁵⁰

Humbjet e forcave serbe ishin të konsiderueshme si në teknikë ashtu edhe në forca. Kadri Kastrati, zëvendëskomandant i ZOLL-it, lidhur me humbjet e forcave serbe, pohon: *“Disa ditë pas betejës, në takimin me oficerin e OSBE-së Mike Tim (oficer amerikan), në bisedë e sipër derisa kemi folur për humbjet e forcave serbe, ai konfirmoi se ato nga fushëbeteja kishin tërhequr të dëmtuara nëntë automjete të blinduara. Ndërsa nga raportet tjera të sjella në zonë, gjatë gjithë betejës (24-27 dhjetor 1998) janë vrarë dhjetëra pjesëtarë të forcave serbe dhe janë shkatërruar disa transportier e automjete të tjera luftarake”*.⁵¹ Gazeta *Kosova Sot*, më 27 dhjetor 1998, në artikullin me titull “Llapi në erë të barutit”, të përgatitur nga gazetarët Njomza Behra dhe Nazmi Elezi, për humbjet e forcave serbe në betejë, mes tjerash shkruan: *“Armikut i janë shkaktuar humbje të mëdha në teknikë luftarake duke i shkatërruar tetë tanke. Ata, po ashtu pësuan edhe në njerëz”*.⁵² Ndonëse shifrat lidhur me dëmet e forcave serbe janë të papërcaktuara, nënkuptohet se në Betejën e Llapashticës, përkundër epërsisë numerike dhe arsenalit luftarak, ato pësuan humbje të ndjeshme.

⁵⁰ Sipas Nuredin Ibishit, Idriz Shabanit, Ajet Poterës, Rifat Malokut dhe Hasim Blakqorit: *“Më 24 dhjetor 1998, nga Brigada 151 “Zahir Pajaziti” ranë dëshmorë Skënder Zejnullahu, Miftar Zejnullahu, Lulzim Jashari, Remzi Demolli dhe Jetullah Kastrati, ndërsa nga Brigada 152 “Shaban Shala” ranë dëshmorë luftëtarët Isa Havolli, Avni Selmani, Fatmir Selmani dhe Bajram Murati. Gjatë luftimeve janë plagosur ushtarët Avdyll Cakiqi dhe Naim Selmani, si dhe janë lënduar disa të tjerë”*. Më gjerësisht: Intervistë me Nuredin Ibishin, Idriz Shabanin, Ajet Poterën, Rifat Malokun dhe Hasim Blakqorin, mars-qershor 2022; Sipas Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, *Buletini, Tetor-dhjetor, 1998, Viti VIII, nr. 9, 35, më 24 dhjetor 1998 në fshatin Gllamnik* writen Hetem Zeqir Selmani (25.06.1951), Salih Zeqir Selmani (25.06.1951), Mirsad Hakif Abdullahu (01.03.1981) dhe Behxhet Ramiz Maqani (28.03.1967) nga fshati Gllamnik. Në fshatin Llapashticë e Ulët vritet Ajvaz Rrahim Potera (17.04.1951). Në Podujevë vriten Albana Safet Hajdari (30.03.1993) dhe Shefkije Sheqir Salihu (15.08.1958). Sipas të dhënave të fundit të Komisionit Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të dëshmorit të kombit, invalidit, veteranit, pjesëtarit dhe të internuarit të luftës së UÇK-së, Hetem Zeqir Selmani (25.06.1951) dhe Salih Zeqir Selmani (25.06.1951), janë shpallur dëshmorë të UÇK-së në ZOLL.

⁵¹ Intervistë me Kadri Kastratin, mars 2022.

⁵² *Kosova Sot*, “Llapi në erë të barutit”, Prishtinë, e diele, 27 dhjetor 1998, f. 3.

Skender ZHITIA

SUMMARY

THE BATTLE OF LLAPASHTICA (DECEMBER 24-27, 1998): MEMOIRS OF THE KLA SOLDERS OF THE “LLAP OPERATIONAL ZONE”

“Battle of Llapashtica”, in historical terms, is of multiple manifold importance. The myth of undefeatable Serbian military forces, was overcome in this battlefield. Serbia, for the first time admitted, employment of regular military forces. This assertion, at the end of December 1998, was also represented at the US daily “The New York Times”, that cited "on Thursday, the KLA defeated the Serbian army and police". Commander Rrustem Mustafa's stated that "at the “Battle of Llapashtica”, solders of KLA-“Llap Operational Zone” (ZOLL) fought against Serbian army, far larger in number and more equipped with combat equipment; in near combat and with heroism; ascertained that they were aware of the value of freedom; that they were not afraid of military might; demonstrated that in the KLA there was a high military education and determination for freedom; and that the forces of Serbia did not achieve their goal of dispersing the forces of the KLA, or destroying the command post of “ZOLL”.

This is a strong argument that the “Battle of Llapashtica” had an immediate echo at international public and diplomatic opinion and influenced the relevant international factor to accelerate the political and diplomatic process for solving the Kosovo issue and enacting the international “Conference of Rambuje”.

This battle consolidated and strengthened the position of the KLA in diplomatic circles (Euro-Atlantic) and made aware Albanian population to join the military struggle for the liberation of Kosovo. For the Serbian army, it was an important message that the KLA was a serious challenge in the Kosovo war.